REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
23-24/23
02.05.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**PSH. nr. 23/23**
**24/23**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Agon Ramadani- Kryetar, Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "ER-LIS Shpk" me seli ne Prishtinë si dhe ankesës së operatorit ekonomik (OE) "BLENOR Shpk",me seli në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave te ish 21shit dhe ish-Shtypshkronjës se Rilindjes" me nr. të prokurimit: 214-22-13394-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 02.05.2023, mori këtë:

## V E N D I M

I. **Aprovohen,** si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "ER-LIS Shpk", si dhe OE "BLENOR Shpk", të parashtruara në Organin Shqyrtues të Prokurimit me numër protokolli 23/23 si dhe 24/23 me datën 09.01.2023, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave te ish 21shit dhe ish-Shtypshkronjës se Rilindjes" me nr. të prokurimit: 214-22-13394-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, **anulohet,** njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës i datës 30.12.2022 për aktivitetin e prokurimit të cituar si më sipër si dhe lënda kthehet në rivlerësim.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

III. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse Ankuesi ka të dejtë që në afat prej 60 (ditëve) të parashtroj kërkesë për kthimin e mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 31, par 6 të Rregullores për Punën e Bordit të OSHP.

## A r s y e t i m

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 24.11.2022, ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave te ish 21shit dhe ish-Shtypshkronjës se Rilindjes" me nr. të prokurimit: 214-22-13394-5-2-1.

Kërkesat për ri shqyrtim në AK janë bërë me datë 23.12.2022 si dhe 27.12.2022, si dhe vendimi ndaj kërkesave për rishqyrtim për ri shqyrtim nga AK: 30.12.2022.

Me datën: 09.01.2023, OE "ER-LIS Shpk" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 23/23, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "LURN Shpk"- Fushe Kosove, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave te ish 21shit dhe ish-Shtypshkronjës se Rilindjes" me nr. të prokurimit: 214-22-13394-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 90 000,00 €.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 18.01.2023 ka rekomanduar që:

- Të aprovohen si të bazuara ankesat e OE ankues "Er-lis" shpk si dhe OE "Blenor", shpk.
- Lënda të kthehet në rivlerësim.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve përgjithshme të parapara me nenet 6 dhe 7 dhe parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në

mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, konstatohet se:

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimeve të eliminimit ku AK - MPB, ne letrën standarde të datës 21.12.2022, kundrejt ofertës së OE NTG "Er-lis" me seli në Prishtinë, tekstualisht ka theksuar: " *1. Nuk kemi ofruar Vendimin per Menaxherin e Kontrates, siç kane qenë kërkesat në njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e Tenderit dhe 2. Përsoneli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor Ju keni ofruar dëshmi vetëm për nëntë nga stafi i cili do të angazhohet për këtë projekt. Për Kerkesen 2 ne DT është kërkuar".*

Përderisa kundrejt ofertës së OE "Blenor' shpk me seli në Prishtinë, është potencuar: "*Personeli për realizimin e projektit minimumi 15 punëtor. Ju keni ofruar dëshmi vetëm për 14 nga stafi i cili do te angazhohet për ketë projekt.*"

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin e bashkangjitur nga OE ankues dhe atë të lendes se aktivitetit ne fjalë, raportit të ekspertit të jashtëm shqyrtues, vlerëson se ankesat e parashtruara nga të dy OE ankues klasifikohen si të bazuara, ndërsa të gjeturat e ekspertit kanë gjetur mbështetje nga paneli shqyrtues andaj arsyetim e tij llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues

Lidhur me arsyet e eliminimit të OE "Er-lis" shpk, PSH konstaton se ankesa e tij klasifikohet e bazuar si dhe arsyetimi i AK-së nuk qëndron për faktin se lidhur me stafin e kërkuar në ofertën e tij OE ankues poashtu përveç 9 punëtorëve të angazhuar me kontrata në këtë projekt, ka paraqitur edhe listën e punëtorëve të përhershëm të kompanisë nga ATK, e cila përmban 7 punëtorë, andaj duke qenë se në ofertën e tij OE ka paraqitur këto të dhëna, AK lidhur me informata apo sqarime shtesë mund të i drejtohet OE duke aplikuar nenin 72 të LPP-së. Pika tjetër mbi të cilën OE ankues është elimimuar qëndron mbi faktin që në ofertën e OE ankues nuk është paraqitur vendimi mbi caktimin e menaxherit, lidhur me këtë, në ofertën e OE ankues është paraqitur kontrata për punonjësin i cili sipas dispozitave të kontratës caktohet si menaxher i projektit, andaj duke pasur parasysh këtë fakt PSH konform raportit të ekspertizës konstaton se kjo kërkesë është përmbushur, ndërsa poashtu nëse AK konsideron se vendimin mbi caktimin e menaxherit OE duhet ta paraqesin si dokument të posaçëm, atë mund ta kërkojë poashtu duke aplikuar nenin 72 të LPP-së, andaj përfundimisht PSH konform raportit të ekspertizës konstaton se bazuar në arsyetimet e AK-së lidhur me eliminimin e OE ankues, nuk ka pasur bazë të mjaftueshme që OE ankues të eliminohet mbi arsyetimet e sipërcekura.

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE "Blenor" shpk, PSH konstaton se ankesa e tij klasifikohet e bazuar si dhe arsyetimi i AK-së nuk qëndron për faktin se lidhur me stafin e kërkuar në ofertën e tij OE ankues ka të paraqitur gjithsejtë 15 punëtorë, në kuadër të cilit bën pjesë edhe menaxheri i projektit, andaj PSH konstaton se duke qenë se mos-përfshirja e menaxherit si staf i projektit nuk

është specifikuar para dorëzimit të ofertave, e poashtu duke u bazuar në raportin e ekspertizës, PSH konstaton se ky arsyetim eliminimi mbi këtë bazë nuk është i qëndrueshëm, për faktin se kërkesa e DT ka qenë që personeli për realizimin e projektit të jetë minimumi 15 punëtorë, që len të nënkuptohet që edhe menaxheri i projektit përfshihet në këtë kërkesë, ndërsa lidhur me kontratat të cilat mungojnë në ofertë, PSH konsideron se poashtu në këtë rast mund të aplikohet neni 72 i LPP-së (sqarimet/informatat shtesë) për faktin se lista e punëtorëve është paraqitur në ofertën e OE ankues.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK-së KK Malisheve
1x1 OE-ve ankues
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.